

**Njoftim i përqendrimit që i referohet krijimit të një shoqërie të përbashkët plotësisht funksionale e cila do të jetë aktive në sektorin vozitjes inteligjente nga Folksvagen Akciegezellshaft, Gjermani dhe Horizon Robotiks, Ishujt Kajman**

**(lënda nr.08-160/2022)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 14.12.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, është dorëzuar njoftim i përqendrimit që i referohet krijimit të një shoqërie të përbashkët plotësisht funksionale e cila do të jetë aktive në Republikën Popullore të Kinës në fushën e vozitjes inteligjente, nga Folksvagen Akciegezellshaft, me seli të regjistruar në Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani dhe Horizon Robotiks me seli të regjistruar në zyrat e Osiris Interneshnl Kalman Limited, Suit #4-210, Governors Skver, 23 Lajm Tri Baj Avenju, PO Boks 32311, Grand Kajman KYI-1209, Ishujt Kajman.

**-Folksvagen Akciegezellshaft** është shoqëri e cila kuoton në bursë, me seli në Wolfsburg (Gjermani), dhe është shoqëri udhëheqëse e Grupit Folksvagen. Folksvagen Akciegezellshaft merr pjesë në transaksionin e propozuar nëpërmjet KARIAD Estonia, një shoqëri e cila është në pronësi të plotë të KARIAD, që është një shoqëri e varur në pronësi të plotë të Folksvagen Akciegezellshaft.

Grupi Folksvagen është aktiv në mbarë botën në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e makinave të udhëtarëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve të transportit, shasive të autobusëve dhe pjesëve dhe aksesorëve të tyre, motoçikletave dhe motorëve me naftë.

Grupi Folksvagen është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura të mëposhtme:

- Porshe Lizing SHPKNJP Shkup, me seli në Bul., Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup,
- Porshe Broker SHA Shkup, me seli në Bul. Bosnjë dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup,
- SKania Makedonija shpknpj Ilinden, me seli në rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup dhe
- Porshe Maqedoni SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Bosnjë dhe Hercegovinë nr. 3, Shkup.

**-Horizon Robotiks** u themelua në vitin 2015 dhe ofron zgjidhje kompjuterike me efikasitet energjetik për sistemet e avancuara të ndihmës së shoferit dhe drejtimin autonom për automjetet inteligjente, me një mision për ta bërë jetën e njerëzve më të sigurt dhe më të mirë. Horizon Robotiks komercializon produktet e integruara NSPV dhe AV për automjetet e udhëtarëve në Kinë dhe është e përkushtuar të përmirësojë përvojat inteligjente të drejtimit të gjeneratës së ardhshme duke integruar harduerin dhe softuerin, duke përfshirë zgjidhjet kompjuterike të harduerit me fuqi të ulët dhe mjetet e zhvillimit të softuerit të hapur.

Horizon Robotiks merr pjesë në transaksionin e propozuar përmes shoqërisë së saj të varur që është në pronësi të plotë të Horizon togeder Holding Lts.

Horizon Robotiks nuk është aktive dhe nuk realizon të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

**- Ndërmarrja e përbashkët** do të themelohet në Republikën Popullore të Kinës dhe fokusi kryesor i saj i biznesit do të jetë Republika Popullore e Kinës.

Ndërmarrja e përbashkët do të jetë aktive në sektorin e vozitjes inteligjente. Ajo do të jetë aktive në kërkimin, zhvillimin dhe furnizimin e softuerit për zbatimin në vozitjen autonome, sistemet dhe sistemet e automjeteve vetëdrejtuese dhe sistemet në një çip, si dhe në ofrimin e shërbimeve pas shitjes së produkteve të saj dhe trajnimin, këshillimin, testimin dhe shërbimet teknike në lidhje me produktet e saj. Konkretisht, ndërmarrja e përbashkët do t'i furnizojë prodhuesit e automjeteve me çipa për vozitje inteligjente dhe softuerë për vozitje inteligjente, ndaras.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

16.12. 2022

Shkup